

VENDIM
Nr. 408, datë 16.7.2025

**PËR PËRCAKTIMIN E INSTITUCIONEVE QË RIORGANIZOHEN SIPAS
LIGJIT PËR INSPEKTIMIN NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 3, të ligjit nr. 99/2024, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Institucionet me funksione inspektimi në juridiksionin e pushtetit ekzekutiv të qeverisjes qendrore, në fushën e zbatimit të ligjit nr. 99/2024, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, të cilat i nënshtrohen procesit të riorganizimit, janë, si më poshtë vijon:

- a) Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore;
- b) Agjencia Kombëtare e Mjedisit;
- c) Agjencia Kombëtare e Pyjeve;
- ç) Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura;
- d) Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve;
- dh) Autoriteti Kombëtar i Ushqimit;
- e) Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave;
- ë) Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës;
- f) Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit;
- g) Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Trashëgimisë Kulturore;
- gj) Inspektorati Shtetëror Shëndetësor;
- h) Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore;
- i) Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut;
- j) Instituti i Shëndetit Publik.

2. Funksionet inspektuese të Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar dhe të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit transferohen në inspektoratet e reja qendrore, që do të krijohen sipas fushave të inspektimit, që mbulojnë ministrinë përgjegjëse dhe sipas parimeve të ligjit nr. 99/2024, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

3. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Ministria e Brendshme, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe institucionet e përcaktuara në pikat 1 dhe 2 për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku